



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE PLANI VJETOR I PUNËS 2015

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)
Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V), 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

Hyrje / Kontekst

Shteti i Kosovës, në shumë aspekte, është një entitet i ri. Me pavarësinë e arritur në vitin 2008 pas viteve të aparteidit, luftës dhe administrimit nga OKB, ende ekzistojnë shumë probleme që e rëndojnë shtetin e ri, sidomos në raport me mjedisin politik. Aktorët kryesorë në sferën politike vazhdojnë të jenë partitë politike dhe komuniteti ndërkombëtar, me një rol të reduktuar të këtij të fundit, duke krijuar hapësirë për aktorët e tjerë që nga përfundimi i pavarësisë së mbikëqyrur. Trashëgimia e luftës ka qenë ndër faktorët kryesorë ndikues mbi partitë politike në Kosovë. Partitë vazhdojnë të mos kenë pozicione të qarta ideologjike, derisa pjesa më e madhe e anëtarësisë së tyre përbëhet nga njerëz me lidhje familjare dhe të cilët e shohin partinë kryesisht si mundësi për punësim apo gjenerim të të ardhurash me ardhjen e partisë në pushtet. Partitë politike përqipen të marrin sa më shumë pushtet brenda sistemit, ndërsa kjo ka krijuar pasoja të rënda për funksionimin demokratik të shtetit. Aktorët e shoqërisë civile, medias dhe një pjesë e opozitës politike kanë artikulluar shqetësime rreth zaptimit të shtetit. Ndonëse shteti është vendosur në një rrugë drejt stabilitetit dhe politikave dhe praktikave demokratike, ndryshimet janë të ngadalshme dhe qytetarët tregojnë nivele të ulëta besimi në elitat politike. Shteti i së drejtës përballet me rreziqe serioze. Nivele të larta të klientelizmit në procese të emërimeve qeveritare po i rrezikojnë institucionet në bërje të shtetit dhe rrjedhimisht po e vështirësojnë progresin. Si pasojë, administrata e shtetit mbetet tejte e brishtë karshi ndryshimeve politike.

Deri tani, pjesa më e madhe e debatit politik është orientuar drejt çështjeve të mëdha dhe të përgjithshme, përfshi njohjen ndërkombëtare të shtetësisë, liberalizimin e vizave (zona Schengen), MSA me Bashkimin Evropian, si dhe bisedimet me Serbinë. Gjatë zgjedhjeve të fundit lokale dhe qendrore është vërejtur një ndryshim i vogël në debatin publik, duke e rritur fokusin tek çështjet konkrete të politikave publike, përfshi ekonominë, papunësinë, sistemin shëndetësor, sundimin e ligjit, sistemin tatimor, pensionet, etj. Për shembull, gjatë zgjedhjeve lokale 2013, qytetarët kanë treguar interesim të shtuar për debatet mbi politikat publike dhe alternativat. Rezultatet e zgjedhjeve në një numër komunash kanë treguar që zgjedhjet i fituar ata kandidatë për kryetarë komunash që ofruar alternative të politikave publike në vend të thirrjes në trashëgiminë e së kaluarës (psh. Luftës). Ndryshimi cilësor në udhëheqjen e komunave po ndikon në cilësonë e debatit mbi politikat, ku agjenda e politikave e qeverisë qendrore po rridefinohet nga propozimet dhe presioni nga qeveritë lokale. Aktualisht, ka mungesë organizatash të profilizuara në qeverisjen lokale për t'i furnizuar komunat me alternativa të politikave publike. Në këtë pikë, EC vendoset si një aktor relevant për komunat ku vepron dhe për këtë qëllim organizata synon të përmirësojë cilësinë e hulumtimit, informimit dhe alternativave që do të informojnë publikun, dhe qeveritë lokale dhe qendrore. Ky është një rast ideal për të rritur përfshirjen qytetare në proceset e politikëbërjes në qeverisjen lokale.

EC është organizatë me tipare të veçanta në dy aspekte: një, fokusi gjeografik dhe dy, qasja ndaj çështjeve. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillim të politikave. Si rezultat, produktet e politikave kanë arritur një nivel kredibiliteti pasi që merren me burimin e problemeve më shpesh se me simptomat. Për më tepër, organizata trajton çështje të veçanta tematike, si planifikimi urban, politikat kulturore dhe të ngjashme, që mbulohen shumë pak nga organizatat tjera në Kosovë. Komponenta e hulumtimeve e EC kombinohet me sukses me aktivizmin në nivel komuniteti (grassroots), duke krijuar raport ndërvarësie. Përmes aktivizmit në nivele komuniteti, organizata rregullisht komunikon me grupet e komunitetit duke mësuar për çështjet, nevojat dhe problemet e tyre prioritare, të cilat e ushqejnë komponentën e hulumtimit. Këto praktika mundësojnë vendosjen e një agjende të veprimit ku idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht sigurohet përfshirja e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirë-informuar. Kjo qasje mundëson pjesëmarrje më të gjërë qytetare dhe një proces solid dhe gjithëpërfshirës të politikëbërjes.

Vlera dalluese e EC është qeverisja urbane. Aktualisht, nga komunat e Kosovës pritet që të zhvillojnë plane që kërkojnë hulumtim dhe zhvillim të gjerë të politikave. EC ka identifikuar një numër aktorësh që duhet të përfshihen në këto procese, ndërsa përpiqet të jenë pjesë e projekteve të zhvillimit urban. Plani i ri Hapësinor i Kosovës kërkon nga të gjitha qeveritë lokale t'i rishikojnë planet ekzistuese lokale (zhvillimore/urbane) ose t'i zhvillojnë të reja. Kjo do të ketë ndikim në agjendën e zhvillimit lokal ekonomik si dhe iniciativat e bashkëpunimit rajonal. Këto zhvillime kërkojnë që qeveritë lokale të jetë shumë aktive dhe kreative në hartimin e politikave gjithëpërfshirëse që do të integrojnë planifikimin urban dhe hapësinor, zhvillimin ekonomik, turizmin, trashëgiminë kulturore, etj. Në anën tjetër, Strategjia e sapo aprovuar e Qeverisjes Lokale vendos objektiva shtesë për komunat, përfshi: qeverisjen e mirë, zhvillimin e kapaciteteve, pjesëmarrjen qytetare, dhe zhvillimin ekonomik. Të gjitha dokumentet dhe proceset relevante të politikave dhe planifikimit strategjik takohen në konceptin e planifikimit të integruar të politikave publike. Qasja e integruar ndaj zhvillimit të politikave është esenciale për suksesin e qeverisjes lokale, ndërsa EC do të jetë aty për t'i ndihmuar komunat (qendrat kryesore urbane) në përvetësimin e kësaj qasje të politikëbërjes.

Procesi i vazhdueshëm i reformës së qeverisjes lokale dhe i decentralizimit kanë pajisur qeveritë lokale me përgjegjëse shumë të rëndësishme. Kohët e fundit, procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje i është besuar autoriteteve lokale. Ekspertiza e EC në këtë sferë dhe qasja e saj e veçantë ndaj përfshirjes së audiencave të gjera para definimit të alternativave, e vendos organizatën në një pozitë strategjike karshi komunave prkatëse dhe procesit të legalizimit.

Trashëgimia kulturore është vlera tjetër dalluese e EC. Deri tani, politikëbërësit janë udhëhequr nga një perspektivë e ngushtë ndaj trashëgimisë kulturore. Së fundmi, situata ka filluar të ndryshojë, duke u krijuar një momentum i ri për alternativa të politikave pr mbrojtjen dhe trashëgimisë kulturore. Edhe Komisioni Evropian ka filluar të tregojë interesim më të madh për të marrë informacione gjithëpërfshirëse rreth zhvillimeve të fundit në këtë sferë. EC mund të jetë një nga partnerët strategjik të institucioneve të shtetit dhe BE-së në ofrimin e produkteve të politikave që do t'i informojnë në mënyrën më të mirë politikën e trashëgimisë kulturore në rrugën drejt integritimit evropian.

Strategjia 2015 – 2019

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, EC është angazhuar rreth procesit të planifikimit strategjik për vitet e ardhshme të punës. Gjatë planifikimit strategjik, është vërejtur se më e rëndësishme për EC është qasja e saj e përgjithshme sesa temat me të cilat merret. Për këtë arsye, EC shihet më shumë se sa vetëm një organizatë e cila merret me trashëgiminë kulturore, planifikimin urban apo qeverisjen e mirë. Procesi i planifikimit strategjik ishte në thelb një ushtrim për të nxjerrë në pah identitetin e organizatës dhe e vendosjen e kornizave të veprimit bazuar në këtë identitet. Gjatë gjithë këtij ushtrimi, në të cilin morën pjesë një numër i konsiderueshëm personash, u analizuan të gjitha aspektet e veprimit të organizatës. Momenti në të cilin po hartohet ky dokument strategjik përfaqëson një orientim të ri të punës së EC-it, fillim i një periudhe të re në veprimtarinë e organizatës e cila synon të shndërrohet në shembullin më të mirë të organizimit komunitar në Prizren dhe Kosovë.

Një numër i proceseve të rëndësishme ligjore, institucionale dhe politika kanë nisur në qeverisjen lokale në Kosovë. Në mesin e tyre, ndër më të rëndësishmet janë reforma e qeverisjes lokale, rishikimi i dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit lokal, bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal si dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje. Të gjitha këto procese e gjejnë EC me një qasje të re strategjike që synon t'i mobilizojë dhe orientojë resurset ekzistuese dhe të ardhshme për të lehtësuar komunikimin mes

komunitetit dhe qeverisë lokale në Prizren. Sipas orientimit të ri strategjik, EC do të ketë orientim të tërësishëm komunitar, e cila do ta vendosë në pozitën e ndërmetësit për të siguruar pjesëmarrje të njëmendtë qytetare në vendimmarrje. Ky dokument i ridefinon misionin, vizionin dhe vlerat e EC, duke reflektuar në punën e viteve të fundit dhe orientimet strategjike për vitet në vijim. Misioni i organizatës do të jetë: EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Ndërsa vlerat të cilat e udhëheqin punën e organizatës janë: paanshmëria, aktivizmi, orientimi drejt rezultateve dhe komuniteti bazë e veprimmit.

Plani Strategjik i EC është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- Qëllimi Strategjik 1 – Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët,
- Qëllimi Strategjik 2 - Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve,
- Qëllimi Strategjik 3 – Përmbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

Programet

Procesi i planifikimit strategjik ka rishikuar edhe qasjen programore të organizatës. Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC do të funksionojë me këto tri programe:

1. Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)

Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane).


2. Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)

Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit dhe rolin watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.

3. Hulumtim (prodhim i dijes)

Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

Struktura organizative



Qëllimet strategjike

Dokumenti strategjik 2015-2019 i organizatës ka vendosur tri qëllime strategjike për pesë vitet e ardhshme të punës, secili i zbërthyer në objektiva strategjike. Duke filluar nga viti 2015, EC do të angazhohet në përmbushjen e këtyre qëllimeve/objektivave strategjike:

Qëllimi Strategjik 1 – Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët

- Objektiva Strategjike 1.1 – Rritje të pranisë së EC në komunitet ashtu që të avancojmë njohuritë tona, të promovojmë aktivizmin dhe mobilizimin qytetar
- Objektiva Strategjike 1.2 – Thellim i angazhimit, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Qëllimi Strategjik 2 – Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve

- Objektiva Strategjike 2.1 – Ndërveprim me institucionet ashtu që të siguroj marrëdhënie të shëndosh në mes të qytetarëve dhe institucioneve.
- Objektiva Strategjike 2.2 – Rritje e njohurive për temat që EC trajton për të tejkaluar sfidën e mungesës së materialeve/literaturës në këto fusha
- Objektiva Strategjike 2.3. – Ngritje e kompetencës dhe kapaciteteve profesionale.
- Objektiva Strategjike 2.4 – Rritje e ndikimit përmes komunikimit efikas me grupe të ndryshme/komunitet për të transmetuar mesazhin. (PR)

Qëllimi Strategjik 3 – Përmbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike

- Objektiva Strategjike 3.1 – Optimizimi i resurseve, strukturës organizative dhe shtrirjes së përgjegjësive brenda organizatës.
- Objektiva Strategjike 3.2 – Avancim i programeve dhe angazhimit, siguroj menaxhim efikas të organizatës dhe programeve, duke përmbushur me sukses misionin e organizatës.

Objektiva Strategjike 3.3 – Menaxhim financiar, kapacitete për ngritje të fondeve dhe sigurim i qëndrueshmërisë.

Metodat e punës

EC përdor një metodologji të kombinuar të punës. Ndonëse kryesisht njihet si organizatë që vepron në nivel komuniteti (grassroots), EC është duke i konsoliduar kapacitetet hulumtuese dhe analitike vazhdimisht. Ndër komponentët më të fuqishëm të organizatës mbeten fokusi ndaj rrjetëzimit të brendshëm (brenda shoqërisë civile) dhe dialogut të politikave me qeverinë lokale për reformat e domosdoshme. Në vijim, metodat e punës së EC:

- Mobilizimi i komunitetit – parimi qendror i angazhimit të EC është vetorganizimi, që e sheh organizimin komunitar përtej pozicionit që avokon dhe pret zgjidhje vetëm prej institucioneve të shtetit. EC është në komunikim të përhershëm me grupet e komunitetit dhe përmes iniciativave synon t'i mobilizojë këto grupe rreth çështjeve të rëndësishme të qeverisjes dhe zhvillimit lokal,
- Monitorimi i qeverisjes lokale – një përpjekje e vazhdueshme që nuk kufizohet vetëm në organet komunale, por prek edhe gjyqësinë, policinë, qeverinë qendrore, etj. Monitorimi gjeneron informacion të bazuar dhe e pajis organizaën me një numër mjetesh dhe incentivash për aktivitetin avokues, reformën e politikave dhe qeverisjen demokratike,
- Avokimi për ndryshim – një numër mjetesh përdoren për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë ndaj qeverisë lokale dhe qendrore, si dhe institucioneve tjera shtetërore. Veprimet avokuese të EC synojnë ndryshimin në sferat e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale, politikave kulturore lokale dhe mbrojtjes e zhvillimit të trashëgimisë kulturore të Prizrenit,
- Dialogu i politikave – organizata është pjesë e një numri procesesh të dialogut me institucionet shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave. Dialogu për politika publike realizohet përmes mjeteve të ndryshme (MoU, hartim i përbashkët i dokumenteve, zbatim i konsultimeve publike, etj.) dhe synon rritjen e komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve të shtetit përmes zbatimit më efektiv të politikave,
- Rrjetëzimi – EC ka sjellë një dinamikë të re në shoqërinë civile të Prizrenit duke krijuar sinergji mes aktorëve civilë. Përmes Rrjetit të Organizatave të Kulturës, Forumit Transparenca, Iniciativës për Mbrojtjen e Kino Lumbardhit dhe veprimeve të ngjashme, EC ka dëshmuar se rrjetëzimi është mjef efektiv i avokimit dhe ndryshimit, dhe për këtë arsye vazhdon të jetë një nga metodat më të rëndësishme të punës së organizatës,
- Hulumtimi – EC ka prodhuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të hulumtimit. Gjatë dy viteve të fundit, organizata ka investuar rregullisht në ngritjen e cilësisë së hulumtimit, ndërsa prej vitit 2015 EC do të ketë hulumtimin si njërin nga tre programet e organizatës. Për të konsoliduar këtë kapacitet, EC ka përgatitur një plan të veçantë që do të udhëzojë zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese të organizatës.

Projektet dhe iniciativat

Projektet dhe iniciativat kryesore të organizatës në kuadër të tri programeve të saj për vitin 2015, do të jenë:


1. **Qyteti gjithëpërfshirës – planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013-2015)** – gjatë vitit 2015, metodologjia e projektit do të modifikohet dhe nga puna me grupet e komunitetit (me bazë identitare) do të kalohet në organizimin e njësive komunitare në nivel të lagjeve të qytetit. Projekti synon përkthimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në plane të zbatueshme urbane të qytetit të Prizrenit.
2. **Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014-2015)** – gjatë pjesës së parë të vitit 2015 do të realizohen tri intervenimet artistike në hapësirën publike, konferenca rajonale dhe publikimi i raportit të hulumtimit mbi aktivizmin kulturor në Prizren. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2015 do të nisë faza e dytë e projektit, me fokus në intervenimet në hapësirën publike.
3. **Merr Pjesë – platforma e aktivizmit online (2013-2015)** – gjatë vitit 2015 do të synohet funksionalizimi i platformës Merr Pjesë, duke e rritur numrin e përdoruesve. Projekti synon të nxisë aktivizmin online si njëri ndër mjetet e organizimit të komunitetit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale. Gjatë vitit 2015 do të synohet zgjerimi i platformës edhe në komunat e tjera të rajonit të Prizrenit.
4. **Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Prishtinës (2012-2016)** – derisa në Prizren monitorimi i komunës do të kalojë në Forumin Transparenca, në Prishtinë do të vazhdojë puna në dy fusha: ndërtimet pa leje (dhe legalizimi) dhe trashëgimia kulturore me fokus në Qendrën Historike të Prishtinës. Transparenca Online është ndër projektet më afat-gjatë të organizatës, që synon t'i hapë komunat dhe t'i bëjë llogaridhënëse karshi qytetarëve (zgjedhësve).
5. **Urbanism Watch 2015 – urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013-2016)** – mbikëqyrja e sektorit të urbanizmit është një ndër angazhimet qendrore të punës së organizatës në Prizren. Sikurse në vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2015 do të vazhdojë vëzhgimi i përhershëm i urbanizmit, me fokus në Qendrën Historike të Prizrenit. Mbikëqyrja gjatë vitit 2015 do të realizohet përmes një sistemi më të strukturuar të monitorimit (metodologji e vendosur në matricë).
6. **Indeksi i Transparencës Lokale (2015-2016)** – ky është projekt i ri i organizatës, që do të zbatohet në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. I bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse dhe profesionale, Indeksi do të synojë që në baza vjetore të vlerësojë nivelin e transparencës (përfshi trendet) së komunave përkatëse.
7. **Trashëgimia kulturore si shtyllë qendrore e zhvillimit rajonal në Prizren (2013-2015)** – pas krijimit të databazës rajonale të trashëgimisë kulturore (2013) dhe zbatimit të pilot veprimit HAJDE (2014), projekti ka hyrë në fazën kulmore dhe në fillim të vitit 2015 pritet prodhimi i Strategjisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore. Nga momenti i miratimit, 2015 dhe vitet pasuese do të jenë vite të abgazhimit të organizatës për t'u siguruar që dokumenti strategjik do të prodhojë politika konkrete lokale dhe rajonale dhe shfrytëzim të trashëgimisë kulturore për nevoja të zhvillimit ekonomik rajonal.

8. **Zhvillim rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren (2014-2015)** – në mesin e vitit 2015, rajoni i Prizrenit do të pasurohet me një numër produktesh të reja turistike, përfshi edhe një pikë të re turistike të vendosur në qendër të qytetit. Projekti synon të ofrojë një shtytje zhvillimit rajonal përmes promovimit të ofertës turistike të rajonit të Prizrenit.
9. **Gjykatë e Hapur – lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014-2015)** – gjatë vitit të parë, projekti ka ndihmuar Gjykatën Themelore të Prizrenit në zhvillimin e një numri produktesh të komunikimit. Gjatë vitit 2015, projekti do të ndihmojë Gjykatën në zbatimin e këtyre produkteve (me fokus në Strategjinë e Komunikimit). Fokus themelor i projektit do të jetë rritja e transparencës së Gjykatës dhe përmirësimi i komunikimit me grupet e komunitetit.


Iniciativat

1. **Forumi Transparenca** – forum i përbërë nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit që ka për qëllim avancimin e transparencës dhe llogaridhënies së komunës së Prizrenit. Një pjesë e programit për qeverisjen e mirë gjatë vitit 2015 do të bartet në Forumin Transparenca, ndërsa nga viti 2016 EC do të synojë pavarësimin e këtij forumi si entitet që funksionon me kapacitetet e veta dhe i shërben anëtarëve të vetë.
2. **Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren)** – rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. Si pjesë e këtij rrjeti, EC do të vazhdojë të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren, që do të sigurojnë zbatim konkret të zotimeve për zhvillim ekonomik përmes kulturës të vendosura në Planin Zhvillimor Komunal 2025 të Prizrenit.
3. **Kino Lumbardhi** – iniciativa për mbrojtjen e kinos ka ofruar një shembull të mirë se organizimi dhe bashkimi mund të sjellë efekte të dëshiruara. Angazhimi për Kino Lumbardhin do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2015, me synimin që të pengohet privatizimi dhe t'i kthehet në shërbim komunitetit.
4. **Rrjetëzimet** – EC do të vazhdojë të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nacionale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre do të vazhdojë të jetë pjesë e iniciativave të shoqërisë civile në nivelin qendror. Këto iniciativa përfshijnë: zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit Kulturor), etj.

Programi vjetor për vitin 2015 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 24 Janar 2015, në Prizren



Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Kreshnik Basha, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve

Në emër të stafit të organizatës
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv